



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: **ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Organizatrat Ndërkombëtare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i 2-të, semestri i 3-të
Numri i orëve në javë:	4+4
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime:
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka Asistent: Dr.Sc. Selim Daku
Detajet kontaktuese:	Email: dukagjin.leka@uni-gjilan.net & selim.daku@uni-gjilan.net Cel: 044 211 671 & 044353533
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë njohuri të avancuara për Organizatat Ndërkombëtare. Lënda e Organizatave Ndërkombëtare do t'u ofrojë studentëve mundësi që të zhvillojnë njohuritë e tyre për rregullat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me themelimin dhe funksionimin e organizatave ndërkombëtare. Konsideratë të veçantë do t'i jepet historikut të themelimit të organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe kompetencave të tyre, politikave dhe procesit të vendimmarrjes brenda këtyre organizatave. Si pjesë e kësaj lënde, studentëve do t'u ofrohet mundësia që të zhvillojnë njohuritë e tyre edhe për proceset e integriteteve evropiane, duke shqyrtuar me një vështrim të përgjithshëm Unionin Evropian si

	njëra prej organizatave më të suksesshme dhe më të rëndësishme në arenën ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë do të shqyrtohen edhe marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor nëpërmjet Procesit të Stabilizim-Asociimit. Kjo pjesë e lëndës do t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri edhe mbi sfidat praktike me të cilat ballafaqohet Ballkani Perëndimor, në përgjithësi, dhe Republika e Kosovës në veçanti. Studentët do të pajisen edhe me njohuri të përgjithshme mbi një mori organizatash dhe nismash të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë Këshillin e Evropës, OSBE-në, NATO-n, dhe organizata të tjera të ngjashme. Pjesa e fundit e lëndës do të përqendrohet në debatin bashkëkohor që ka të bëjë me rolin e organizatave ndërkombëtare në situatat e pas-konfliktit, në veçanti në rastin e Kosovës. Kjo pjesë do të trajtojë edhe procesin aktual të anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë një analizë dhe diskutim të kërkesave procedurale për anëtarësim në mekanizma kyç ndërkombëtarë, perspektivat për anëtarësim dhe problemet që mund të dalin në proces të anëtarësimit.
Qëllimet e lëndës:	Duke pasur parasysh rolin e organizatave ndërkombëtare në shekullin XX dhe në fillim të shekullit XXI, fare lehtë mund të konkludohet se nevoja për një lëndë të tillë për tu studiuar është shumë e madhe, e sidomos për studentët e fakultetit juridik, pasi që sot roli i organizatave ndërkombëtare ka arritur pothuajse në kulmin e ngritjes së tyre, e sidomos një shembull të tillë na jep gjithnjë e më shumë Unioni Evropian, si një organizatë supranacionale. Për këtë arsye sot shumica e universiteteve të njohura ndërkombëtare në botë kanë lëndën Organizatat Ndërkombëtare si lëndë të veçantë, prandaj edhe ne si Fakultet Juridik i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan nuk mund të bëjmë një përjashtim dhe e kemi parë mëse të nevojshme që kjo lëndë të futet në kurrikulën mësimore të Fakultetit Juridik, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan. Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që ti bëjë të mundur studentëve që të njohin, kuptojnë dhe shpjegojnë strukturën institucionale ndërkombëtare, përfshirë fillet dhe zhvillimin e organizimit ndërkombëtar;
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të: Që të kuptojnë dhe shpjegojnë rolin e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale në procesin e politikëbërjes dhe ligjëbërjes ndërkombëtare; Që të njohin dhe kuptojnë aspekte specifike dhe/ose të specializuara të

	organizatave ndërkombëtare (siç është çështja e anëtarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare apo çështja e procedurave të vendimmarjes);		
	Që të përmirësojnë aftësitë dhe shkathhtësitë analitike, argumentuese dhe kreative tek studentët përmes analizës dhe diskutimit të rasteve dhe të teksteve ligjore.		
	Organizatat Ndërkombëtare është një lëndë sfiduese pasi operon në një arenë politike dhe ekonomike që për nga struktura dhe dinamika dallon nga arena e brendshme e shteteve me të cilën studentët janë më të familjarizuar. Brenda kufizimeve dhe/apo kornizave të përcaktuara kohore, kjo lëndë do të përfshijë një numër të madh temash.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	Javë	4
Ushtrime teorike/laboratorike	1	Javë	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	Javë	2
Kollokfiume,seminare	2 Kollokfiume 1 Punim për Studentë	Javë	3
Detyra të shtëpisë	10	Javë	10
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)			
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	Me kalimin e kohës, metodat akademike ndryshojnë dhe përparojnë. Përqendrimi në mendimin kritik, analitik dhe kreativ do të jetë filozofia qendrore e organizimit dhe mbarëvajtjes së kësaj lënde. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet përmbajtjes së diskutimit dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve gjatë orëve të ligjëratave të kësaj lënde.		
	Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e		

	programit të kësaj lënde mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligj-bërjes ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, me prioritet ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një korrelacion më të përafërt me përvojat dhe nevojat në Kosovë. Me fjalë të tjera, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to. Do të bëhet, gjithashtu, përpjekje për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore të sistemit institucional ndërkombëtar dhe nocioneve më të specializuara, ndonëse orientimi parësor do të jetë i motivuar nga filozofia udhëheqëse, në këtë rast njohuria bazë mund të përftohet lehtë si derivat i diskutimit të përqendruar në probleme të specializuara, përparësia e të cilës empirikisht qëndron në një shkallë më të lartë probabiliteti të ngritjes apo rritjes së aftësisë ose shkathhtësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike. Pastaj metodat e tjera bashkëkohore, të cilat do të përdoren gjatë procesit të mësim-dhënies dhe mësim-nxënies do të jenë edhe metodat interaktive, përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, ndarja në grupe të vogla diskutuese, përmes prezantimeve, punimeve seminarike, testeve provuese, pregaditjes së rasteve të ndryshme për studim, analizimi i rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si në aspektin e mbrendshëm, poashtu edhe në aspektin ndërkombëtar, etj.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 40 pikë Detyrat e shtëpisë: 20 pikë (1 detyra – punim seminarik x 20 pikë – obligative për notën 9 dhe 10) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Totali: 100 pikë. Provimi përfundimtar: 100 pikë Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, <i>Pjesa e Gjashtë: Organizatat Ndërkombëtare</i> (Prishtinë, 2007).

	Karen A. Mingst, “Bazat e Marredhenjve Nderkombetare, AIIS per botimn shqip, 208. Bashkim Zahiti, “<i>E Drejta Evropiane</i>”, botimi i dytë.
Literatura shtesë:	Musa Limani, “<i>Integrimet Ekonomike Evropiane</i>”, 2008. Blerim Reka, “<i>Kushtetuta e EU - Rubikoni i Supranacionales</i>”, 2007. Blerim Reka dhe Arta Ibrahim, “<i>Studime Evropiane</i>”, Tetovë 2004. Blerim Reka dhe Ylber Sela. <i>Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian</i>. Tetovë: Arbëria Design, 2007. Blerim Reka dhe Ylber Sela. <i>Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian – E Drejta Kushtetuese dhe e Drejta Institucionale e UE-së</i>. Tetovë: Arbëria Design, 2011. Blerim Reka, Otmar Holl dhe Ylber Sela. <i>Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian</i>. Tetovë: Arbëria Design, 2010. Fausto Pocar, “<i>E drejta e Komuniteteve Evropiane</i>”, 1998. Besfort Rrecaj. <i>Hyrje në Organizatat Ndërkombëtare</i>. Prishtinë: Qendra Juridike e Kosovës, 2011. “<i>Libri i Bardhë për Përgatitjen e Vendeve të Asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore për Integrimin në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian</i>” Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/1158676591-Libri%20i%20Bardhe.pdf - “<i>15 Pyetje për Bashkimin Evropian</i>” Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/1199717851-15_pyetje_be.pdf - “<i>Glosar për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian</i>” Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/glosar_per_integrimin_european.pdf
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	HYRJE Prezentim i përmbajtjes së lëndës, metodave, organizimit dhe

	kërkesat e lëndës; Diskutime dhe sqarime për të gjitha çështjet që studentët mund ti preokupojnë e që kanë lidhje me lëndën.
<i>Java e dytë:</i>	NOCIONI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE KLASIFIKIMI I TYRE
<i>Java e tretë:</i>	TEORITË E MARREDHENJVE NDERKOMBETARE – SPJEGIMI I ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE SIPAS TEORIVE KRYESORE TE MARREDHENJVE NDERKOMBETARE
<i>Java e katërt:</i>	ORGANIZATAT E PËRGJITHSHME NDËRKOMBËTARE: SISTEMI I KOMBEVE TË BASHKUARA – STRUKTURA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
<i>Java e pestë:</i>	KAPACITETI LEGJISLATIV I OKB-SË DHE PERSONALITETI I SAJ LIGJOR (përfshirë interpretimin e Kartës së OKB-së)
<i>Java e gjashtë:</i>	SIGURIA KOLEKTIVE SIPAS SISTEMIT TE KOMBEVE TË BASHKUARA
<i>Java e shtatë:</i>	TESTI MES-SEMEMSTRAL
<i>Java e tetë:</i>	MBROJTJA E TE DREJTAVE TE NJERIUT SIPAS SISTEMIT TE KOMBEVE TE BASHKUARA
<i>Java e nëntë:</i>	BASHKIMI EVROPIAN DHE ORGANIZATAT E TJERA EVROPIANE
<i>Java e dhjetë:</i>	ROLI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË PARA VITIT 1999 (mekanizmat e OKB-së dhe të OSBE-së)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	ROLI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË PAS VITIT 1999 (UNMIK-ut, BE-së/EULEX-it, OSBE-së)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE: PROCESI, PERSPEKTIVAT DHE PROBLEMET
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	ORGANIZATAT E TJERA NDERKOMBETARE
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	TESTI PËRFUNDIMTAR
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	PROVIMI PËRFUNDIMTAR
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Për të gjitha sjelljet akademike të studentëve do të implementohet me saktësi RREGULLORJA PËR MASAT DHE PROCEDURËN DISIPLINORE PËR PERSONELIN AKADEMIK DHE STUDENTËT e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan, të cilën mund ta gjeni në linkun:	
https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2015/03/Rregullore_p%C3%ABr_Masat_dhe_Procedur%C3%ABn_Disiplinore_p%C3%ABr_Personelin_Akademik_dhe_Student%C3%ABt_948536.pdf	